

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik në pozicionin “Laborant” në Departamentin e Shkencave të Tokës.

Përshkrimi i punës:

Laboranti/ja do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me pedagogët e lëndës së Gjeokimisë për realizimin e punëve laboratorike me studentët, të kryejë analiza kimike instrumentale dhe në rrugë analitike për doktorantët dhe stafin akademik të interesuar, të mirëmbajë pajisjet laboratorike, sipas standardeve të cilësisë dhe sigurisë.

Kandidati duhet të plotësojë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë Diplomë Bachelor në Kimi të Përgjithshme, Kimi Industriale ose Kimi Ushqimore.
2. Të ketë përvojë paraprake mbi 3-vjeçare në një laborator kimie është një domosdoshmëri.
3. Të ketë njohuri praktike në përdorimin e pajisjeve laboratorike dhe metodave standarde të kimisë analitike.
4. Të ketë aftësi për të ndjekur me përpikëri udhëzimet dhe procedurat standarde të punës.
5. Të ketë aftësi për të punuar në një ambient të shpejtë dhe për të menaxhuar kohën në mënyrë efektive.
6. Të ketë njohuri në fushën e sigurisë dhe higjenës në laborator.
7. Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të jetë i/e aftë për të punuar në grup.
8. Të ketë njohuri të mira kompjuterike.
9. Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimi (CV) sipas formatit standard;

3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **19.11.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.